

7. EKUMENIZËM

Dialogu mes të krishterëve të ndryshëm të bashkuar nga një Pagëzim i vetëm, zë një vend të veçantë në ecjen sinodale. Çfarë marrëdhënies ka bashkësia jonë kishtare me pjesëtarët e traditave të tjera dhe të emërtimeve të krishtera? Çfarë bashkëndajmë dhe në çfarë mënyre ecim të bashku? Çfarë frytësh kemi nxjerrë duke ecur së bashku? Cilat janë vështirësitë? Si mund ta kryejmë hapin tjetër që të përparojmë në ecjen tonë së bashku?

8. AUTORITET DHE PJESËMARRJE

Një Kishë sinodale është një Kishë pjesëmarrëse dhe bashkëpërgjegjëse. Si mundet bashkësia jonë kishtare t'i gjejë objektivat për t'i zbatuar, mënyrën për t'i arritur dhe hapat për t'i kryer? Si ushtrohet autoriteti ose qeverisja në brendësi të Kishës sonë vendore? Si zbatohen punët në grupe dhe bashkëpërgjegjësia? Si kryhen vlerësimet dhe nga kush? Si promovohen shërbesat dhe përgjegjësia e laikëve? A kemi pasur përvoja të frytshme të sinodalitetit në nivel vendor? Si funksionojnë organizmat sinodalë në nivelin e Kishës vendore (Këshillat Baritorë në famulli dhe në dioqeza, Këshillat Presbiterialë, etj.)? Si mund ta favorizojmë një qasje më sinodale në pjesëmarrjen dhe udhëheqjen tonë?

9. TË SHOSHITËSH DHE TË VENDOSËSH

Në një stil sinodal, marrim vendime përmes shoshitjes së asaj që Shpirti Shenjt po thotë nëpërmjet krejt bashkësisë sonë. Cilat metoda dhe mjete përdor dioqeza në këtë proces? Si mund të përmirësohen ato? Si e promovojmë pjesëmarrjen në procesin vendimmarrës në brendësi të

strukturave hierarkike? A na ndihmojnë metodat tona vendimmarrëse që ta dëgjojmë krejt popullin e Hyjit? Cila është marrëdhënia mes konsultimit dhe procesit vendimmarrës dhe si i zbatojmë ato? Cilat mjete dhe procedura përdorim për të promovuar transparencën dhe përgjegjësinë? Si mund të rritemi në shoshitjen shpirtërore bashkësiore?

10. TË FORMOHESH NË SINODALITET

Sinodaliteti mbart pranimin e ndryshimit, formimin e mirëkuptimit të vazhdueshëm. Si mundet bashkësia jonë kishtare të formojë persona më të aftë për të "ecur së bashku", duke dëgjuar njëri-tjetrin, duke marrë pjesë në mision dhe duke u angazhuar në dialog? Çfarë formimi jepet për të shoshitur ushtrimin e autoritetit në mënyrë sinodale?

Siti Web i Sinodit jep sugjerime mbi mënyrën sesi t'i shtrosh këto pyetje në grupe të ndryshme të personave në mënyrë të thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse. Çdo dioqezë, famulli ose grup kishtar, nuk duhet medoemos t'iu përgjigjet të gjitha pyetjeve, por duhet të shoshitë dhe të përqendrohet tek ato aspekte të sinodalitetit që i konsideron më të rëndësishme në kontekstin e vet. Pjesëmarrësit janë të inkurajuar të bashkëndajnë me ndershmëri dhe sinqeritet përvojat e tyre të jetës reale dhe të reflektojnë së bashku rreth asaj që Shpirti Shenjt mund të zbulojë përmes asaj që bashkëndajnë mes tyre.



**Konferenca
Ipeshkvnore
e Shqipërisë**

www.kish.al
cealbania_al@yahoo.com

Pyetësori i Sinodit



Për një Kishë sinodale
bashkim | pjesëmarrje | mision

Pyetja themelore e konsultimit

Ky Sinod, shtron disa pyetje themelore: Një Kishë sinodale "ecën së bashku" në shpalljen e Ungjillit. Si po ndodh kjo "ecje së bashku" sot në Kishën tuaj vendore? Cilët janë hapat që Shpirti na fton të bëjmë që të rritemi në "ecjen së bashku" tonën? (DP, 26).

Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje jemi të ftuar që:

- Të kujtojmë përvojat tona: Cilat përvoja të Kishës sonë vendore na kujton kjo pyetje?

- T'i rilexojmë këto përvoja në mënyrë më të thellë: Cilat gëzime kanë sjellë? Në cilat vështirësi dhe pengesa kanë hasur? Cilat plagë kanë nxjerrë në pah? Cilat intuita kanë ngjallur?
- Të mbledhësh frytet për t'i bashkëndarë: A jehon në këto përvoja zëri i Shpirtit Shenjt? Çfarë na kërkon Shpirti? Cilat janë pikat që duhen pohuar, perspektivat për t'i ndryshuar, hapat për të kryer? Ku regjistrojmë një konsensus? Çfarë rrugësh hapen për Kishën tonë vendore?

Temat e mëposhtme nxjerrin në pah disa aspekte domethënëse të “sinodalitetit të jetuar”, që t'i ndihmojnë personat për t'u thelluar në këto pyetje themelore (DP 30). Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, është e dobishme të kujtosim se “ecja së bashku” ndodh në dy mënyra thellësisht të lidhura mes tyre. Së pari, ecim së bashku si Popull i Hyjit. Së dyti, ecim së bashku si Popull i Hyjit, por me mbarë familjen njerëzore. Këto dy perspektiva pasurojnë njëra-tjetrën dhe rezultojnë të dobishme për shohitjen tonë të përbashkët drejt një bashkimi më të thellë dhe një misioni më prodhues.

Pyetjet që shoqërojnë secilën prej dhjetë temave të mëposhtme mund të përdoren si pikënisje ose si një udhërrëfyes i dobishëm. S'është e thënë që bashkëbisedimi dhe dialogu juaj të ndalet tek pyetjet që janë të thjeshtësuara më poshtë:

1. SHOKË UDHËTIMI

Në Kishë dhe në shoqëri jemi krah për krah në të njëjtën rrugë. Në Kishën vendore, cilët janë ata që “ecin së bashku”? Cilët janë ata që duken më larg? Si jemi të thirrur të rritemi si shokë? Cilat grupe ose individë janë lënë pas dore?

2. DËGJIMI

Të dëgjosh është hapi i parë, por kjo lyp një mendje dhe një zemër të hapur, pa paragjykim. Në çfarë mënyre Zoti po na flet përmes zërave që ndonjëherë i injorojmë? Si dëgjohen laikët, në veçanti gratë dhe të rinjtë? Me sa vëmendje i dëgjojmë atë që ndodhen në periferi? Si integrohet kontributi i të kushtuarve dhe i të kushtuarave? Cilat janë limitet e aftësisë sonë për dëgjim, në veçanti ndaj atyre që kanë pikëpamje të ndryshme nga tonat? Çfarë hapësire i lëmë zërave të pakicës, në veçanti të personave që përjetojnë varfërinë, braktisjen ose përjashtimin social?

3. TË FLASËSH QARTË

Të gjithë janë të ftuar që të flasin me guxim dhe parresia, d.m.th. në liri dhe në dashuri. Çfarë të lejon ose të pengon të flasësh me guxim, çiltërsi dhe me përgjegjësi, në Kishën tonë vendore dhe në shoqëri? Kur dhe si arrijmë ta themi atë që është e rëndësishme për ne? Cila është marrëdhënia me mediat vendore (jo vetëm ato katolike)? Kush flet në emër të bashkësisë së krishterë dhe si zgjidhet ai/ajo?

4. KREMTIMI

“Ecja së bashku” është e mundur vetëm nëse është e themeluar mbi dëgjimin bashkësior të Fjalës dhe mbi kremtimin e Eukaristisë. Lutja dhe kremtimet liturgjike e frymëzojnë dhe në mënyrë efektive e udhëheqin jetën tonë të përbashkët dhe misionin e bashkësisë sonë. Në çfarë mënyre i frymëzojnë vendimet më të rëndësishme? Si e promovojmë pjesëmarrjen aktive të të gjithë besimtarëve në liturgji? Çfarë hapësirë iu jepet pjesëmarrësve të shërbesave të lektoratit dhe të akolititit?

5. TË BASHKËNDASH PËRGJEGJËSITË NË MISIONIN TONË TË PËRBASHKËT

Sinodaliteti është në shërbim të misionit të Kishës, tek e cila janë të ftuar të marrin pjesë të gjithë pjesëtarët. Meqë të gjithë jemi dishepuj misionarë, në çfarë mënyre është i thirrur të marrë pjesë në misionin e Kishës çdo i pagëzuar? Çfarë i pengon të pagëzuarit të jenë aktivë në mision? Cilat zona të misionit jemi duke lënë pas dore? Si i mbështet bashkësia, pjesëtarët e saj që i shërbejnë shoqërisë në mënyra të ndryshme (angazhim social dhe politik, kërkim shkencor, edukim, promovim të drejtësisë sociale, mbrojtje e të drejtave njerëzore, kujdes për ambientin, etj.)? Si i ndihmon Kisha këta pjesëtarë në mënyrë që ta jetojnë shërbimin e tyre ndaj shoqërisë në mënyrë misionare? Si ndodh shohitja mbi zgjedhjet misionare dhe nga kush?

6. DIALOGU NË KISHË DHE NË SHOQËRI

Dialogu kërkon qëndrueshmëri dhe durim, por të lejon edhe mirëkuptimin reciprok. Në çfarë mase popujt e ndryshëm që janë pjesë e bashkësisë sonë, dialogojnë mes tyre? Cilat janë vendet dhe mjetet e dialogut të jashtëm në Kishën vendore? Si e promovojmë bashkëpunimin me dioqezat e afërta, bashkësitë rregulltare të zonës, shoqatat dhe lëvizjet laikale, etj.? Si trajtohen dallimet e këndvështrimeve, konfliktet dhe vështirësitë? Cilat problematika specifike të Kishës dhe të shoqërisë duhet të kemi kujdes më shumë? Cilat përvoja dialogu dhe bashkëpunimi kemi jetuar me besimtarët e besimeve të tjera dhe me ata që nuk kanë asnjë përkatësi fetare? Në çfarë mënyre Kisha dialogon dhe mëson nga sektorët e tjerë të shoqërisë: nga pjesa e politikës, e ekonomisë, e kulturës, e shoqërisë civile dhe e personave që jetojnë në varfëri?